



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.239/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Violeta Rugova Husaj - kryesuese, Hajriz Hoti dhe Bujar Muzaqi - anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Valon Brahimit, kandidat për asamble komunale në Mitrovicën e Jugut nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) të paraqitur kundër komisionerëve të Komisionit Komunal të Zgjedhjeve (KKZ), Mitrovicë, për shkak të parregullsive gjatë numërimit në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN) për Zgjedhjet Lokale, të mbajtura më datë 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur me 20.10.2025, merr këtë:

V E N D I M

PRANOHET E BAZUAR ankesa ZL.Anr.239/2025, e datës 17.10.2025, e parashtruar nga Valon Brahimi, kandidat për asamble komunale në Mitrovicën e Jugut nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) paraqitur kundër komisionerëve të Komisionit Komunal të Zgjedhjeve (KKZ), Mitrovicë e Jugut për shkak të parregullsive gjatë numërimit në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN) për Zgjedhjet Lokale, të mbajtura më datë 12 Tetor 2025, ashtu që **URDHËROHET** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), që fletëvotimet në vendvotimin Nr.1110/01, dhe 1110/06, Mitrovicë e Jugut, t'i rinumëroj.

A r s y e t i m

Me datën 17.10.2025, PZAP-i ka pranuar ankesën e kandidatit për asamble komunale nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me të cilën pretendon se me datë 14.10.2025, në ora 10:30 kanë marrë informatë nga komisionerët dhe vëzhguesit se në vendvotimin 1110/06 në shkollën "Fazli Grajqevci" në Shipol të Mitrovicës, numri i fletëvotimeve brenda në kuti të votimit ka qenë 311 fletëvotime, ndërsa në pikën 5 të formularit të vendvotimit në përshkrimin "Numri i nënshkrimeve në listën e votuesve figuron 310". Dallimi në mes pikës 5 dhe 8 është 1(një) fletëvotim. Sipas parashtruesit të ankesës, kjo situatë përmes dokumenteve përkatëse dëshmon manipulimin në procesin zgjedhor, respektivisht të votave përmes të ashtuquajturit "treni bullgar". Prandaj, ankuesi kërkon nga organet kompetente që çështja të trajtohet komfort rregullores 12/2024 dhe çështja në fjalë lidhur më kutinë e lartcekur të kthehet në numërim ose rivotim. Problematika e njëjtë shfaqet edhe në klasën përkatësisht vendvotimin 1110. Si prova, parashtruesi i ankesës në ankesë ka

bashkangjitur: Formularët e plotësuar pas përfundimit të zgjedhjeve për kryetar dhe kandidatet për zgjedhjet komunale 2025 për vendvotimet 1110/06 dhe 1110/01, Librin e Evidencës po ashtu për të dy vendvotimet.

Në përgjigjen në ankesë KQZ ka deklaruar se pas pranimit të kërkesës për përgjigje së PZAP ka kontaktuar me KKZ e Komunës së Mitrovicës së Jugut, të cilët kanë deklaruar se sipas të dhënave të evidentuara në, të Ekipit të Numërimit, po ashtu edhe në raportin e dërguar në QNR, kemi dhënë komentin. Sa i përket çështjes së mospërputhjes sipas nenit 15 të Rregullores Zgjedhore nr.14/2024 për QNR, parashihet procedura në rast të mospërputhjes së rezultateve preliminare të FRS dhe FRK, paragrafi 3 i së cilës thekson se: Në rast të mos konstatimit të mospërputhjeve, kur numri i nënshkrimeve në LV është më i madh se numri i fletëvotimeve në kuti atëherë rasti evidentohet dhe kutia përkatëse e votimit rekomandohet në KQZ për rinumërim. Ndërsa lidhur me vendvotimin 1110/06 dallimi në mes rubrikës 8 dhe 5 është 0.

Si provë KQZ ka bashkëngjitur përgjigjen e KKZ të Komunës së Mitrovicës së Jugut, Librin e evidencës nga QKN, Librin e votimit për vendvotimin 1110/01 dhe 1110/06 dhe formularët digjital për ato vendvotime.

Paneli, pasi që shqyrtoi dhe vlerësoi pretendimet ankimore, përgjigjet në ankesë ka gjetur se:

-Ankesa është e bazuar.

Paneli vlerësoi se pretendimet e parashtruara në ankesë nga subjekti politik PDK- Valon Brahimi, provat e parashtruara dhe përgjigjen në ankesë nga KQZ dhe konstatoj se pretendimet ankimore janë të bazuara , pasi nga provat e siguruara është vërtetuar se ka mospërputhje se nënshkrimeve dhe fletëvotimeve në kutinë e votimit në vendvotimet 1110/01 dhe 1110/06, në Komunën e Mitrovicës së Jugut.

Nga provat e siguruara nga subjekti ankues rezulton kjo gjendje faktike: vendvotimin 1110/06 në shkollën “Fazli Grajqevci” në Shipol të Mitrovicës, numri i fletëvotimeve brenda në kuti të votimit ka qenë 311 fletëvotime, ndërsa në pikën 5 të formularit të vendvotimit në përshkrimin “Numri i nënshkrimeve në listën e votuesve figuron 310”. Dallimi në mes pikës 5 dhe 8 është 1(një) fletëvotim. Ndërsa në vendvotimin 1110/01 numri i fletëvotimeve brenda në kuti të votimit ka qenë 358 fletëvotime, ndërsa në pikën 5 të formularit të vendvotimit në përshkrimin “Numri i nënshkrimeve në listën e votuesve figuron 359”. Dallimi në mes pikës 5 dhe 8 është 1(një) fletëvotim. Këto të gjetura janë të konstatuara nga formularët e plotësuar për Zgjedhjet lokale 2025.

Paneli duke u mbështetur në nenin 13 par. 12.1 të Rregullores Për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosies së Ankesave Nr.01/2025, konstaton se në fletëvotimet 1110/01 dhe 1110/06 ka pasur mospërputhje mes numrit të nënshkrimeve në Listën e Votuesve dhe numrit të fletëvotimeve në kutinë e votimit, përkatësisht se në vendvotimin 1110/01 ka qenë një nënshkrim më shumë në Listën e Votuesve në krahasim me kutinë e fletëvotimit, dhe në vendvotimin 1110/06 është një nënshkrim më shumë në Listën e Votuesve në krahasim më

kutinë e votimit, gjë që rezulton me parregullsi, të cilat duhet të verifikohen edhe njëherë nga Komisioni Qendror i zgjedhjeve (KQZ) duke bërë rinumërimin, e veçanërisht duke marr parasysh vendvotimin 1110/06 ku është konstatuar dallim nga provat e parashtruara nga subjekti ankues dhe provave e siguruara nga KQZ.

Andaj, paneli e aprovoj ankesën, bazuar në dispozitën e nenit 105 i LZP-së Nr. 08/L-228, i cili decidivisht përcakton: *“Ankesat lidhur me administrimin e numërimit në QKN dhe QNR, dorëzohen me shkrim pranë PZAP-së, brenda dyzetë e tetë (48) orëve nga ndodhja e shkeljes së supozuar”,* si dhe Rregullores Për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosijes së Ankesave Nr.01/2025, neni 13 *“në rast se PZAP konstaton se ka ndodhur shkelje e LZP-së dhe rregullave zgjedhore të KQZ-së para certifikimit të rezultateve zgjedhore është në kompetencë të PZAP që në raste të jashtëzakonshme:12.1. të urdhëroje KQZ-në që të rinumëroj fletëvotimet në një vendvotim apo qendër votimi.”*

Nga të gjitha këto arsye e duke u bazuar në dispozitat e nenit 105 , neni 118 par. 1 të LZP-së Nr.08/L-228, lidhur me nenin 13 par. 12.1 të Rregullores Për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosijes së Ankesave Nr.01/2025, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
ZL.Anr.239/2025, datë 20.10.2025

Kryesuese e Panelit
Violeta Husaj Rugova



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.